

**Datë: 22/10/2020**

**KONTRATË SHITJE  
TË KUOTAVE TË KAPITALIT TË SHOQËRISË  
I.R.E.A SHPK**

**Znj. Ilda Rusi**, atesia Asllan, e datelindjes 27.06.1987, lindur ne Fier dhe banuese ne Tirane rr Abdi Kazani Hryja 2, Ap 13 ,identifikuar me karte identiteti me nr.personal I75627072N, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

(Ketu e meposhte referuar si **“Shitesi”**)

**Z. Besard Rusi**, atesia Besnik, i datelindjes 20.11.1983, lindur ne Shkoder dhe banues ne Tirane rr “Abdi Kazani” Hryja 2, Ap 13, identifikuar me karte identiteti me nr.personal I31120064G, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar.

(Ketu e meposhte referuar si **“Bleresi”**)

Shitesi dhe Blerësi do të referohen bashkërisht si **“Palët”**.

Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë të Shitjes së kuotave të shoqërisë me kushtet e mëposhtme:


**DEKLARIME PARAPRAKE:**

- Shitesi zotëron 50% të kapitalit me një vlerë totale prej 50 Lekë të shoqërisë **“I.R.E.A”** sh.p.k, me Nr. N.I.P.T:L82128016O, (këtu e mëposhtë referuar si **“Shoqëria”**).
- Blerësi zotëron 50% të kapitalit me një vlerë totale prej 50 Lekë të shoqërisë **“I.R.E.A”** sh.p.k, me Nr. N.I.P.T:L82128016O, (këtu e mëposhtë referuar si **“Shoqëria”**).

**Neni 1**

**Objekti i Kontratës**

- 1.1 Me anë të kësaj kontrate Shitesi i transferon Blerësit me anë të shitblerjes, 50% te kuotave kapitalit te shoqerise, me nje vlere te pergjithshme prej 50 Leke te ndodhura ne pronesi te tij.
- 1.2 Blerësi deklaron se pranon të bleje pjesët (kuotat) e kapitalit të Shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate.
- 1.3 Transferimi nëpërmjet shitblerjes do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqipëtar në fuqi dhe më veçanërisht me dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit Nr. 9901/2008 të ndyshuar, *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”*.



## **Neni 2**

### **Çmimi dhe mënyra e pagesës**

- 2.1 Transferimi i pjesëve (kuotave) të kapitalit të shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate nga Shitësi tek Blerësi është kryer për kundrejt çmimit prej 50 Lekë.
- 2.2 Palët deklarojnë se çmimi i përcaktuar në nenin 2.1 të kësaj kontrate është paguar tërësisht nga Blerësit në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

## **Neni 3**

### **Kalimi i Pronësisë**

- 3.1 Pas nënshkrimit të kësaj kontrate Blerësi bëhet zotëruar te perkatesisht 50% të kuotave kapitalit të Shoqërisë duke u bërë titullare e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me to, përfshirë pjesëmarrjen në fitimet e Shoqërisë, sipas përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë.

## **Neni 4**

### **Garancitë**

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se kapitali i shoqërisë objekt të kësaj kontrate, janë të transferueshme dhe të lira nga çdo barrë, hipotekë apo çdo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 4.2 Shitësi deklaron se Shoqëria ka depozituar dhe paguar rregullisht dhe në kohë të gjitha tatimet, taksat, pagesa të kontributit shoqëror, kontribute të çdo lloji, zbritje apo mbajtje të çdo tipi të aplikuar në Republikën e Shqipërisë në lidhje me të ardhurat, fitimet, pasuritë neto, doganat, vlerës së shtuar apo çdo referencë tjetër, në nivel kombëtar apo lokal të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

## **Neni 5**

### **Forca Madhore**

- 5.1 Asnjëra nga Palët nuk do të konsiderohet përgjegjëse në rast se plotësimi i çfarëdoq dispozite vendosur në këtë Kontratë do të vonohet ose do të ndalohet për shkak të forcave madhore ose rastit faktor dhe në mënyrë të vecantë për shkaqet si, revolucione, çrregullime, lëvizje popullore, luftra, greva, zjarre, përmytje, tërmete, fenomene të natyrës, shtetëzime, shpronësime, ose akte të pushtetit qendror apo lokal që kufizojnë lirinë personale apo të sipërmarrjes.

## **Neni 6**

### **Interpretimi i Kontratës në tërësi**

- 6.1 Çdo kusht apo formulimi që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e terësisë së Kontratës dhe brenda qëllimit që i bëri Palët të nënshkruajnë këtë Kontratë.

#### **Neni 7**

#### **Legjislacioni i zbatueshem**

- 7.1 Për sa i përket çështjeve që kjo Kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e neneve të Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë si dhe ligje, dispozita e norma të tjera që janë në fuqi, të cilat drejtëpërdrejtë apo tërthorazi lidhen me objektin e kësaj kontrate.

#### **Neni 8**

#### **Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

- 8.1 Palët bien dakort që çdo mosmarreveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes Palëve. Në rast se bisedimet nuk do të japin rezultat, atëherë konflikti do të zgjidhet nga Gjykata e Shkalles së Parë Tiranë Shqipëri.

#### **Neni 9**

#### **Shpenzimet**

- 9.1 Shpenzimet për regjistrimin e kësaj kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit do të jenë në ngarkim të Palëve.

#### **Neni 10**

#### **Ndryshimet**

- 10.1 Çdo ndryshim i përmbajtjes së kësaj Kontrate, duhet të bëhet me shkrim dhe do të firmoset nga Palët.

#### **Neni 11**

#### **Hyrja ne fuqi**

- 11.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.

#### **Neni 12**

#### **Gjuha e kontratës**

- 12.1 Kontrata perpilohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën Shqipe.  
12.2 Kontrata mbasi ju lexua paleve me ze te larte dhe te qarte dhe ata deklaruan se e kuptuan permbajtjen dhe pasojat ligjore te saj e nenshkruajne rregullisht .Kontrata e shitjes u redaktua ne baze te nenit 705 e vijusa te Kodit Civil .

**PALËT**

**SHITËSI**

**Ilda Rusi**

*Ilda Rusi*  
*Ilda*

**BLERËSI**

**Besard Rusi**

*Besard Rusi*